REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Nr. Protokollit: 01-060/01-85233
Data: 13 Nëntor 2026
Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e
Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e XI-të rregullte për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 27.11.2026 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërëjtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 27.10.2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës, për vitin 2027.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Plani të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.
6. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 88/2026 mbi Kompensim e Komiteteve Konsultative, sipas kërkesës së MF-së, me nr. prot. 1924-1/26, dt. 08.10.2026.
7. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 91-2026 mbi Kompensimin e anëtareve të KKSB, sipas kërkesës së MF-së, me nr. prot. 1923-1/26, dt. 08.10.2026.
8. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 92 -2026 mbi Kompensimin e kryetarëve të Këshillave Lokale, sipas kërkesës së MF-së, me nr. prot. 1925-1/26, dt. 08.10.2026
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së KKSB-së për vitin 2027.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës së marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërkomunal për **Qendren për Zhvillim Rajonal Perëndimi**, në mes të Komunave: Pejë, Deçan, Istog dhe Klinë.

11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi draft Planin paraprak Vjetor të Prokurimit Publik për vitin 2027 në Komunën e Pejës.

12. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar. (*Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Enjten, me dt. 26 Nëntor 2026).*
13. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

KRYESUES I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Nr. Protokollit:
Data: 13 Nëntor 2026
Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e
Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e XI-të rregullte për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 27.11.2026 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërëjtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 27.10.2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës, për vitin 2027.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Plani të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.
6. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 88/2026 mbi Kompensim e Komiteteve Konsultative, sipas kërkesës së MF-së, me nr. prot. 1924-1/26, dt. 08.10.2026.
7. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 91-2026 mbi Kompensimin e anëtareve të KKSB, sipas kërkesës së MF-së, me nr. prot. 1923-1/26, dt. 08.10.2026.
8. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 92 -2026 mbi Kompensimin e kryetarëve të Këshillave Lokale, sipas kërkesës së MF-së, me nr. prot. 1925-1/26, dt. 08.10.2026
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së KKSB-së për vitin 2027.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës së marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërkomunal për **Qendren për Zhvillim Rajonal Perëndimi**, në mes të Komunave: Pejë, Deçan, Istog dhe Klinë.

11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi draft Planin paraprak Vjetor të Prokurimit Publik për vitin 2027 në Komunën e Pejës.

12. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar. (*Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Enjten, me dt. 26 Nëntor 2026).*
13. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

KRYESUES I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

Propozim për normën tatimore për vitin 2027

Bazuar Ndryshimin dhe Plotësimin e të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, neni 9, pika 4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv dhe e cila dallon nga vitet e mëhershme kur kemi pas shkalle tatimore ne baze te kategorive te pronave. Meqenëse MF vitin e kaluar e ka shtyrë aplikimin e normës progresive tatimor propozojmë qe norma tatimore e aprovuar vitin e kaluar e e cila është pezulluar për vitin aktual te votohet e njëjta për vitin tatimor 2027:

1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro	**0.10 %;**
1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro	**0.20%**,
1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro	**0.30 %**,
1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro	**0.40 %**,
1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro	**0.50%**,.

Arsyetim:

Meqenëse kemi te bëjmë me fillimin e shkalles progresive dhe me qellim qe ti shmangim te panjohurat eventuale te vlerësimit te kombinuar me aplikimin e shkalles progresive **jemi te mendimit qe te startojmë me shkallen bazike** pasi qe ne te ardhmen mund ta rrisim por jo edhe ta zvogëlojmë sepse sipas ligjit e njëjta duhet te ketë trend progresiv.

LIGJI NR.08/L-190

PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj përcakton parimet themelore, orientimet, përgjegjësitë e institucioneve, instrumentet financiare dhe rregullat për zhvillim rajonal të balancuar në Republikën e Kosovës.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e (BE-së) Nr.1301/2013 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit datë 17 dhjetor 2013 për Fondin Europian të Zhvillimit Rajonal dhe dispozitat e posaçme në lidhje me investimin për qëllime të zhvillimit dhe krijimit të vendeve të punës dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr.1080/2006.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj përcakton strukturën institucionale përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar, parimet dhe kriteret për nxitjen e zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar, përcaktimin e instrumenteve të financimit dhe skemave financiare për nxitjen e zhvillimit rajonal të balancuar, si dhe aspekte të tjera që sigurojnë zhvillimin rajonal të balancuar, ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Kosovës duke inkorporuar praktikat e mira të Bashkimit Evropian sa i përket zhvillimit rajonal të balancuar dhe politikave të kohezionit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin si vijon:

1.1. Rajon zhvillimor - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal të balancuar, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial;

1.2. Zhvillim rajonal i balancuar - nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturor e mjedisor, ndërmjet rajoneve të ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor;

1.3. Pabarazi rajonale - nënkupton gjendjen kur evidentohen dallime substanciale në mes të rajoneve zhvillimore sipas indikatorëve socio-ekonomik;

1.4. Politikat e zhvillimit rajonal të balancuar - nënkuptojnë kornizën e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal të balancuar me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të zbatohen për arritjen e synimit të zhvillimit rajonal të balancuar. Varësisht nga ndryshimet dhe avancimi i dokumenteve strategjike, objektivat e zhvillimit rajonal të balancuar, do t'i referohen dhe adaptohen ndryshimeve të fundit;

1.5. Plani operacional për zhvillim të rajoneve zhvillimore - nënkupton dokumentin bazë të planifikimit strategjik për rajonin e caktuar zhvillimor, i cili përcakton objektivat dhe prioritetet e zhvillimit për zonën e rajonit zhvillimor, me theks të veçantë nxitjen e zhvillimit të balancuar brenda rajonit zhvillimor;

1.6. Ministria - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal;

1.7. Qendrat për zhvillim rajonal - nënkuptojnë qendrat që themelohen në përputhje me Ligjin përkatës për bashkëpunimin ndër-komunal dhe në përputhje me rregulloren për funksionimin dhe organizimin e këtyre qendrave që miratohet nga ministria;

1.8. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar- nënkupton dokumentin programues në kuadër të buxhetit të ministrisë si mekanizëm për financimin apo bashkëfinancimin e projekteve për zhvillim rajonal të balancuar, si dhe planeve operacionale të rajoneve zhvillimore dhe krijohet nga kontributi i buxhetit shtetëror por mund të përfshijë edhe burime tjera të financimit.

1.9. Zonë Urbane - nënkupton zonën e cila fizikisht formon pjesën e një qyteti dhe karakterizohet me pjesë të rëndësishme të sipërfaqeve të ndërtuara, densitetit të lartë të popullsisë dhe banimit, punësim dhe transport të konsiderueshëm dhe infrastrukturë tjetër. Zonat urbane mund gjithashtu të përmbajnë zona të gjelbra zakonisht të shfrytëzuara për qëllime rekreative.

1.10. Zonë Rurale - nënkupton një sipërfaqe që karakterizohet me një sasi të ultë të ndërtimit, dendësisë së popullsisë, dhe të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale, si dhe të punësimit përmes zhvillimit të agrikulturës, turizmit rural, qendrave shëruese dhe të prodhimtarisë që nuk ndot mjedisin rrethues.

1.11. NUTS - nënkupton "Nomenklaturën e Njësive Territoriale Statistikore" të përcaktuar nga Agjencia Statistikore Evropiane si një sistem hierarkik i ndarjes së territorit ekonomik të Bashkimit Evropian për qëllimet e mbledhjes, zhvillimit dhe harmonizimit të rajoneve evropiane statistikore dhe analizës socio-ekonomike të rajoneve. "NUTS-1" nënkupton rajonet e mëdha socio-ekonomike tremilionë (3.000.000) deri në shtatëmilionë (7.000.000) banorë; "NUTS-2" nënkupton rajonet bazike për aplikimin e politikave rajonale tetëqindmijë (800.000) deri në tremilionë (3.000.000) banorë; si dhe "NUTS- 3" nënkupton rajonet e vogla për qëllime specifike njëqindepesëdhjetëmijë (150.000) deri në tetëqindmijë (800.000) banorë.

Neni 4
Parimet e Zhvillimit Rajonal të Balancuar

1. Parimet për nxitjen e zhvillimit rajonal të balancuar, në kuptim të këtij ligji janë si vijon:

1.1. Parimi i partneritetit dhe bashkëpunimit - nënkupton që zhvillimi rajonal i balancuar bazohet në bashkëpunimin ndërmjet akterëve relevantë nga sektori publik, privat dhe shoqëria civile Konkretisht, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale, bashkëpunimin ndër-komunal dhe ndër-kufitar siç përcaktohet me Ligjin përkatës për

bashkëpunim ndër-komunal, operatorëve ekonomikë, përfaqësuesve nga akademia, partnerët social dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat duhet të përfshihen në procesin e përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit, të dokumenteve për zhvillim rajonal të balancuar;

1.2. Parimi i transparencës - nënkupton që proceset e planifikimit dhe menaxhimit të zhvillimit rajonal të balancuar të jenë publike, duke garantuar informimin e qytetarëve dhe palëve tjera të interesuara, për të gjitha proceset e zhvillimit rajonal të balancuar;

1.3. Parimi i Programimit - nënkupton ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të programimit shumëvjeçar sipas objektivave të planifikimit financiar, për zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar rajonal;

1.4. Parimi i planifikimit - nënkupton planifikimin e zhvillimit rajonal të balancuar duhet të bëhet nëpërmjet dokumenteve për planifikim shumëvjeçar, si kusht paraprak për shpërndarjen e fondeve për zhvillim rajonal të balancuar;

1.5. Parimi i qëndrueshmërisë - nënkupton se politikat e zhvillimit rajonal të balancuar kontribuojnë në harmonizimin dhe balancimin e zhvillimit rajonal, për të siguruar mbrojtje të diversitetit natyror dhe trashëgimisë kulturore, duke respektuar faktorët ekonomik dhe social gjatë procesit të dizajnimit të politikave për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal;

1.6. Parimi i bashkërendimit - nënkupton bashkërendimin ndër-institucional lidhur me zhvillimin rajonal të balancuar, duke përfshirë shpërndarjen e fondeve në rajonet zhvillimore në përputhje me objektivat dhe prioritetet që përcakton programi nacional për zhvillim rajonal të balancuar dhe dokumentet tjera planifikuese, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ekuilibruar shoqëror dhe ekonomik;

1.7. Parimi i harmonizimit - nënkupton se politikat për zhvillimin rajonal të balancuar bazohen në solidaritetitin e përbashkët për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe veçanërisht fokusohen në stimulimin e mëtutjeshëm të zhvillimit rajonal të balancuar dhe zvogëlimin e dallimeve në kuptim të zhvillimit rajonal;

1.8. Parimi i subsidiaritetit - nënkupton se përgatitjen dhe realizimin e masave për zhvillim rajonal të balancuar, për të rritur efikasitetin në rajonet zhvillimore, për aq sa është e mundur, e kryejnë njësitë e vetëqeverisjes lokale, përveç nëse janë të përjashtuara nga kompetenca e tyre dhe si të tilla ushtrohen nga niveli qendror;

1.9. Parimi i bashkëfinancimit - nënkupton se financimi i zhvillimit rajonal të balancuar do të sigurohet nga grumbullimi i resurseve financiare prej burimeve të ndryshme, të dedikuara për përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve planifikuese dhe zhvillimit të projekteve që kanë ndikim në zhvillimin rajonal të balancuar;

1.10. Parimi i monitorimit dhe vlerësimit - nënkupton se zbatimi i politikave të zhvillimit rajonal të balancuar është sistematikisht i monitoruar dhe vlerësuar, për të siguruar rritje të efektivitetit, efikasitetit dhe ndikimit në zhvillimin rajonal të balancuar.

Neni 5
Kriteret për zhvillim rajonal të balancuar

1. Kriteret për zhvillim rajonal të balancuar përcaktohen si vijon:

1.1. Indeksi socio-ekonomik: përcaktohet sipas formulës nga ministria, sipas përllogaritjes së mesatares së katër indikatorëve: prodhimi i brendshëm bruto për kokë banori sipas rajoneve zhvillimore; të ardhura buxhetore për kokë banori; rritja e vlerës së shtuar të sektorit jo-financiar dhe shkalla e papunësisë;

1.2. Indeksi demografik: përcaktohet sipas formulës nga ministria, përllogaritet sipas mesatares së katër indikatorëve: rritja natyrore; indeksi i plakjes; bilanci i migrimeve për njëmijë (1000) banorë; dhe studentët e diplomuar për njëmijë (1000) banorë;

1.3. Indeksi i zhvillimit: përcaktohet sipas formulës nga ministria, e cila përllogaritet sipas mesatares së indeksit socio - ekonomik dhe indeksit demografik.

2. Të dhënat statistikore për indikatorët nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, institucionet dhe organizatat tjera relevante.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton formulën, metodologjinë, kriteret dhe rregullat për matjen e performancës rajonale dhe monitorimin e zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.

KAPITULLI II
POLITIKAT PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

Neni 6
Rajonet Zhvillimore

1. Rajonet zhvillimore definohen me këtë ligj për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal të balancuar dhe realizimit të masave dhe instrumenteve për nxitjen e zhvillimit rajonal të balancuar.

2. Rajonet zhvillimore përcaktohen vetëm për qëllime të intervenimit sektorial në komunat e përcaktuara dhe nuk përbëjnë organizim të ri administrativ apo territorial.

3. Numri i rajoneve zhvillimore është në përputhje me numrin e shtatë (7) rajoneve statistikore sipas klasifikimit NUTS-3 të përcaktuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës.

Neni 7
Dokumentet dhe politikat e zhvillimit rajonal të balancuar

1. Zhvillimi rajonal i balancuar mbështetet në dokumentet planifikuese ku përcaktohen prioritetet dhe programet e zhvillimit rajonal të balancuar të cilat i përgatit ministria dhe i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratim.

2. Planet Operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore janë dokumente që përgatiten nga rajonet zhvillimore në bashkëpunim me komunat e rajonit zhvillimor përkatës dhe miratohen në përputhje me standardet dhe rregullat e përcaktuara nga ministria.

Neni 8
Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar është dokument i programimit që përcakton aktivitetet për arritjen e objektivave sipas prioriteteve për zhvillim rajonal të balancuar, burimet financiare dhe autoritetet përgjegjëse.

2. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar përcakton drejtimet prioritare të zhvillimit rajonal të balancuar përmes projekteve afatshkurtra dhe afatmesme si dhe financimin e tyre në mënyrë që të krijojë zona socio - ekonomike të qëndrueshme në kuadër të rajonit zhvillimor duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për zhvillimin rajonal të balancuar.

3. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar propozohet nga Ministria për një periudhë afatmesme dhe miratohet nga Qeveria, me mundësi rishikimi në baza vjetore gjatë procesit të planifikimit buxhetor për secilin vit fiskal.

Neni 9
Planet Operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore

1. Planet Operacionale për zhvillim të rajoneve zhvillimore janë dokumente bazë të planifikimit të cilat përcaktojnë objektivat dhe përparësitë e rajonit zhvillimor me theks të veçantë nxitjen e zhvillimit të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale brenda rajonit zhvillimor, si dhe nxitjen e zhvillimit për zonat më pak të zhvilluara brenda rajonit zhvillimor.

2. Planet Operacionale për rajonet zhvillimore hartohen në përputhje me parimin e partneritetit dhe bashkëpunimit sipas procedurave dhe metodologjisë së përcaktuar nga Ministria me kontributin e njësive të vetëqeverisjes lokale të koordinuar nga qendrat për zhvillim rajonal në kuadër të një rajoni zhvillimor.

3. Planet Operacionale financohen nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe njëherësh duhet të jenë në përputhje me këtë Program.

4. Planet Operacionale miratohen për një periudhë tre (3) vjeçare dhe mund të rishikohen sipas nevojës dhe arsyeshmërisë duke ndjekur metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria.

5. Ministria koordinon procesin e hartimit, monitorimit dhe vlerësimit të planeve operacionale për zhvillim rajonal.

6. Ministria me akt nënligjor përcakton procedurat, udhëzimet dhe metodologjinë për procesin e hartimit dhe monitorimit të planeve operacionale të rajoneve zhvillimore.

KAPITULLI III
FINANCIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL TË BALANCUAR

Neni 10
Burimet e financimit të zhvillimit rajonal të balancuar

1. Burimet e financimit të zhvillimit rajonal të balancuar në Republikën e Kosovës janë:

1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;

1.2. Fondet e Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë;

2. Për nxitjen e zhvillimit rajonal të balancuar në Republikën e Kosovës sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore, në bazë vjetore Ministria në bashkërendim me Ministrinë përkatëse për Financa ndan mjete nga buxheti vjetor i Republikës së Kosovës për të përkrahur zhvillimin rajonal të balancuar.

3. Procesi i planifikimit të burimeve të financimit bëhet në përputhje të plotë me ciklin e planifikimit buxhetor vjetor sipas afateve kohore që i përcakton Ministria përkatëse e financave.

4. Komponenta e zhvillimit rajonal të balancuar është pjesë integrale e dokumenteve planifikuese buxhetore afatshkurtra dhe afatmesme.

5. Programi për zhvillimin rajonal të balancuar është mekanizëm për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve për zhvillim rajonal të përfshira në këtë program si dhe planit operacional për zhvillimin rajonal të rajonit zhvillimor.

6. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar krijohet si nën-program buxhetor i veçantë në kuadër të buxhetit të Ministrisë.

7. Programi përfshinë shumat e alokuara në çdo vit fiskal nga buxheti publik i alokuar në kuadër të buxhetit të Ministrisë në përputhje me nenin 10 paragrafit 2 të këtij ligji.

8. Buxheti alokohet në funksion të zbatimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Planit Operacional të rajonit zhvillimor në përputhje me parashikimet e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm dhe menaxhohet nga Ministria.

9. Programi për Zhvillimin Rajonal të Balancuar shfrytëzohet për qëllimet e zhvillimit rajonal të balancuar në fushat si vijon:

9.1. përmirësimi i sektorëve të industrisë, nivelit të teknologjisë, si dhe qasjes në teknologji të reja;

9.2. promovimi i kërkimit dhe zhvillimit;

9.3. përmirësimi i konkurrencës rajonale ndërmjet rajoneve zhvillimore;

9.4. zhvillimi i balancuar ndërmjet zonave rurale dhe urbane brenda rajoneve zhvillimore;

9.5. përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit;

9.6. zhvillimi i turizmit;

9.7. zhvillimi i zonave të pazhvilluara;

9.8. mbështetja e bizneseve;

9.9. rritja dhe promovimi i punësimit;

9.10. përmirësimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;

9.11. përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës;

9.12. përmirësimi i bashkëpunimit ndër-komunal, ndër-komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar për çështjet me interes të përbashkët, në përputhje me Ligjin përkatës për bashkëpunimin ndër-komunal;

9.13. përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve zhvillimore, në nivel të rajonit zhvillimor dhe njësive të vetëqeverisjes lokale;

9.14. menaxhimi dhe administrimi i zbatimit të planit operacional për zhvillimin rajonal në kuadër të rajonit zhvillimor;

9.15. përmirësimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

9.16. avancimi i zhvillimit social dhe kulturor;

9.17. qëllime të tjera në përputhje me këtë ligj.

Neni 11
Përfituesit e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Përfitues të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar janë subjektet si vijon:

1.1. Komunat si dhe institucionet tjera në nivel të komunës;

1.2. Qendrat për zhvillim rajonal të rajonit zhvillimor, si dhe organizatat e shoqërisë civile ashtu siç përcaktohen me Ligjin përkatës për lirinë e asocimit;

1.3. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore;

1.4. Bizneset.

2. Përfituesit potencialë të këtyre aktiviteteve përcaktohen nga Ministria në përputhje me Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Planin Operacional të rajoneve zhvillimore.

Neni 12
Menaxhimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Zbatimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës që rregullon kontrollin dhe menaxhimin financiar për financat publike në Republikën e Kosovës.

2. Programi për zhvillim rajonal të balancuar ndahet për projekte të caktuara për zhvillimin rajonal të rajoneve zhvillimore, zonave urbane dhe zonave rurale, sipas formulës dhe metodologjisë së përcaktuar nga Ministria.

3. Ministria mirëmban bazën e të dhënave të projekteve të financuara nga Programi për Zhvillim Rajonal të balancuar dhe harton raporte periodike.

4. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e burimeve financiare të programit, duke përfshirë edhe formulën e financimit, kriteret, vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të projekteve që financohen nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

5. Projektet nga fusha e zhvillimit rajonal të balancuar që përfshihen në Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Planet Operacionale të rajoneve zhvillimore mund të bashkë-financohen nga burime të ndryshme financimi, siç janë përcaktuar me nenin 10 të këtij ligji.
6. Rastet e bashkëfinancimit, vlerat dhe rregullat e detajuara për bashkëfinancimin e projekteve përcaktohen në harmoni me dokumentet planifikuese, marrëveshjen e bashkëfinancimit në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin përkatës.

Neni 13
Menaxhimi i fondeve të fushave sektoriale për zhvillim rajonal të balancuar

1. Menaxhimi i fondeve të fushave sektoriale bëhet nga Ministritë sektoriale në përputhje me legjislacionin përkatës për menaxhimin e financave publike në Republikën e Kosovës.

2. Ministria mirëmban bazën e të dhënave të projekteve nga fushat sektoriale që përkojnë me zhvillimin rajonal të balancuar, harton raporte vjetore dhe informon Qeverinë e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI IV
STRUKTURA INSTITUCIONALE PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

Neni 14
Institucionet dhe trupat përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar

1. Institucionet përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar janë:

1.1. Qeveria e Republikës së Kosovës;

1.2. Ministria;

1.3. Komunat.

2. Trupat përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar:

2.1.Qendrat për zhvillim rajonal për rajonet zhvillimore.

3. Politikat për zhvillim rajonal të balancuar i propozon ministria, ndërsa i miraton qeveria.

Neni 15
Ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal

1. Ministria ka përgjegjësitë si vijon:

1.1 është përgjegjëse për përgatitjen e politikave dhe legjislacionit nga fusha e zhvillimit rajonal të balancuar;

1.2. shqyrton planet operacionale të rajoneve zhvillimore;

1.3. monitoron punën e Qendrave për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore;

1.4. është autoritet menaxhues për programin e zhvillimit rajonal të balancuar të Ministrisë.

1.5. përgatitë raporte periodike për implementimin, monitorimin dhe menaxhimin e projekteve të zhvillimit rajonal të balancuar;

1.6. miraton metodologjinë dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve të zhvillimit rajonal të balancuar, si dhe projekteve specifike me rëndësi rajonale, urbane dhe rurale sipas paragrafit 4 të nenit 12 të këtij ligji;

1.7. koordinon aktivitetet ndër-institucionale për hartimin e dokumenteve strategjike nga fusha e zhvillimit rajonal të balancuar;

1.8. përgatitë dhe zbaton projekte, studime fizibiliteti dhe analiza në funksion të zhvillimit rajonal të balancuar;

1.9. mbështetë komunat në zhvillimin e kapaciteteve për përgatitjen e projekteve, menaxhimin e tyre në kuadër të rajoneve zhvillimore dhe akterët e tjerë të zhvillimit;

1.10. kryen sipas rastit menaxhimin dhe/apo zbatimin e programeve të përbashkëta në kuadër të rajoneve zhvillimore, bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi dhe partneriteti për këtë qëllim me partnerët e zhvillimit dhe financuesit në përputhje me legjislacionin përkatës për bashkëpunimin ndër-komunal;

1.11. zhvillon treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

1.12. krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave të zhvillimit rajonal të balancuar;

1.13. kryen detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës.

Neni 16
Qendrat për zhvillim rajonal

1. Qendrat për zhvillim rajonal, themelohen në kuadër të shtatë (7) rajoneve zhvillimore në përputhje me rajonet statistikore sipas klasifikimit NUTS-3 të përcaktuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës.

2. Procedura e themelimit të Qendrave për zhvillim rajonal realizohet sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-komunal në harmoni me Ligjin përkatës për bashkëpunimin ndër-komunal.

3. Fushëveprimtaria e Qendrave për zhvillim rajonal në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji është përcaktuar si vijon:

3.1. mbështetje në procesin e hartimit të politikave dhe programeve për zhvillim rajonal të balancuar si dhe planeve të tyre përkatëse të zbatimit në përputhje me nenet 8 dhe 9 të këtij ligji;

3.2. koordinimi i procesit të hartimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të rajoneve përkatëse zhvillimore dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

3.3. zhvillimi dhe zbatimi i projekteve dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve tjera që veprojnë në rajonet përkatëse zhvillimore në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim realizimin e Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal në rajonet zhvillimore;

3.4. mbështetja e organizatave të sektorit privat në rajonet përkatëse zhvillimore, në avancimin e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve investuese, me qëllim të shfrytëzimit më efikas të mundësive për mbështetje financiare nga programet qeveritare dhe donatorëve, me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillim ekonomik;

3.5. grumbullimi i të dhënave statistikore dhe informatave tjera relevante nga institucionet përgjegjëse për rajonet përkatëse zhvillimore të cilat janë të nevojshme për matjen e ndryshimeve tek indikatorët socio-ekonomik të ndërlidhur me zhvillimin rajonal të balancuar të cilat shfrytëzohen për proceset e raportimit dhe të planifikimit.

4. Ministria nxjerrë rregullore për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore.

Neni 17
Monitorimi dhe vlerësimi

1. Ministria shqyrton planet operacionale për zhvillim rajonal sipas rajoneve zhvillimore në përputhje me legjislacionin përkatës për vetëqeverisje lokale.

2. Ministria monitoron zbatimin e planeve operacionale të rajoneve zhvillimore.

3. Ministria në bashkëpunim me komunat e rajonit zhvillimor përkatës monitoron punën e Qendrave për Zhvillim Rajonal.

KAPITULLI V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18
Dispozitat kalimtare

Institucionet dhe trupat përgjegjëse që aktualisht kryejnë funksione zbatimi lidhur me zhvillimin rajonal, do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e ngarkuara deri në miratimin e dokumenteve të planifikimit, programimit dhe akteve nënligjore për zhvillim rajonal të balancuar siç përcaktohet me këtë ligj.

Neni 19
Aktet nënligjore

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve, Qeveria me propozim të Ministrisë miraton aktet nënligjore si në vijim:

1.1. Rregullore për menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar;

1.2. Rregullore për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore;

1.3. Rregullore për standardet, metodologjinë dhe sistemin e hartimit dhe monitorimit të Planeve Operacionale për zhvillim rajonal të rajonave zhvillimore;

1.4. Rregullore për performancë rajonale dhe monitorim të zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr.08/L-190
13 korrik 2023

Shpallur me dekretin Nr. DL-138/2023, datë 01.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 02 - 439
Data. Datum. Date. 26. 06. 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
DALËSE / IZLAZNA / OUTGOING
Nr./Br./No 635
Nr.faq / Br.str / No.pg
Data / Datum / Date 25 / 06 / 2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

24.06.2026

Për: Kryetarëve të Komunave të Rajonit Zhvillimor Perëndim
z. Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës, Pejë;
z. Bashkim Ramosaj, Kryetarë i Komunës, Deçanit;
z. Ilir Ferati, Kryetar i Komunës, Istog;
z. Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës, Klinë;

Subjekti: Nismë për themelimin e Qendrës për Zhvillim Rajonal - Perëndim

Të nderuar Kryetarë,

Me anë të kësaj shkrese, kam kënaqësinë të paraqes një nismë të rëndësishme që synon të përmirësojë zhvillimin socio-ekonomik të komunave tona përmes themelimit të Qendrës për Zhvillim Rajonal - Perëndim.

Qendra për Zhvillim Rajonal do të jetë e dedikuar në përmirësimin e kualitetit të jetesës së qytetarëve, të ofrojë një ambient më të përshtatshëm ekonomik për zhvillimin e bizneseve dhe të rris ndikimin e masave të zhvillimit ekonomik duke zgjeruar raportin kost-benefit të ndarjeve buxhetore, duke shfrytëzuar efektet sinergjike dhe duke aplikuar qasje të planifikimit inovative.

Qendra për Zhvillim Rajonal do të funksionojnë mbi bazën e marrëveshjes të dal në përputhje me Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ligjin përkatës për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe kriterin NUTS 3. Bazuar në kriterin NUTS 3, Qendrat për Zhvillim Rajonal operojnë në shtatë rajone zhvillimore.

Për të realizuar këtë nismë, është e domosdoshme të bashkëpunojmë së bashku si komuna dhe të angazhohemi për krijimin e një partneriteti që do të sigurojë suksesin e Qendrës për Zhvillim Rajonal. Ju ftojmë që të angazhohemi aktivisht në këtë proces dhe të ndihmoni në përcaktimin e nevojave dhe prioriteteve që do të adresohen nga këto qendra.

Shpresojmë se kjo nismë do të sjellë përfitime të rëndësishme për qytetarët tanë dhe do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunave tona.

Bashkangjitur keni:

- Rregulloren (QRK) NR. 32/2024 për Themelimin, Funksionimin, Organizimin dhe Monitorimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në Rajonet Zhvillimore;

- Draft Marrëveshjen për Bashkëpunim Ndër-Komunal sipas Rajoneve Zhvillimore.

Faleminderit për vëmendjen tuaj dhe për angazhimin në këtë proces të rëndësishëm!

Me respekt,

z. Rasim Demiri
Ministër në detyrë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

z. Elbert Krasniqi
Ministër në detyrë i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

RREGULLORE (QRK) - NR. 32/2024 PËR THEMELIMIN, FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE MONITORIMIN E QENDRAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL NË RAJONET ZHVILLIMORE[1]

Rregullore (QRK) Nr. 32/2024 për Themelimin, Funksionimin, Organizimin dhe Monitorimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në Rajonet Zhvillimore, është miratuar në mbledhjen e 223-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 11/223, të datës 09.10.2024.[1]

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93, të paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19, paragrafit 1.2, të Ligjit nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/7 gusht 2023), nenit 8, paragrafit 4 (4.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Miraton:

RREGULLORE (QRK) - NR. 32/2024 PËR THEMELIMIN, FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE MONITORIMIN E QENDRAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL NË RAJONET ZHVILLIMORE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton mënyrën e themelimit, organizimit, funsionimit dhe monitorimit të punës së Qendrave për Zhvillim Rajonal në shtatë (7) Rajonet Zhvillimore të Kosovës në lidhshmëri me zbatimin e dispozitave të neneve 16 dhe 17 të Ligjit NR.08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Rregulloret e BE-së 1299/2013, 1301/2013 dhe 1303/2013.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për Qendrat për Zhvillim Rajonal në rajonet zhvillimore përkatëse.

KAPITULLI II
QENDRAT PËR ZHVILLIM RAJONAL

Neni 3
Themelimi i Qendrave për Zhvillim Rajonal

1.Në përputhje me Nenin 6, përkatësisht pikën 1 dhe 2 të Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar Qendrat për Zhvillim Rajonal janë trupa përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar të cilat themelohen bazuar në nenin gjashtëmbedhjetë (16) të Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ligjit perkatës për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe kriterin NUTS të përcaktuar nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

2.Qendrat për Zhvillim Rajonal bazuar në paragrafin 1 të këtij neni themelohen në shtatë (7) rajone zhvillimore në bazë të marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit ndërkomunal, sipas klasifikimit NUTS-3 të përcaktuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

3.Procesi i Marrëveshjeve për Bashkëpunim Ndërkomunal do të bashkërendohet nga Ministria përgjegjegjëse për Zhvillim Rajonal, Ministria përgjegjëse e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunat bazuar në paragrafin 1 të Nenit 3.

Neni 4
Funksioninimi

1. Qendrat për Zhvillim Rajonal funksionojnë mbi bazën e marrëveshjes të dalë në përputhje me Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ligjin perkatës për Bashkpunim Ndërkomunal dhe kriterin NUTS. Bazuar në kriterin NUTS Qendrat për Zhvillim Rajonal operojnë në shtatë rajone zhvillimore.

2. Rajonet Zhvillimore janë të harmonizuara me Rajonet Statistikore (shih shtojcën nr. 1).

Neni 5
Organizimi

1. Organizimi i Qendrave për Zhvillim Rajonal përcaktohet me Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndërkomunal.

2. Qendrat për Zhvillimit Rajonal do të sigurojnë stafin përkatës për zbatimin e detyrave të përcaktuara me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe partneritetit në mes institucioneve dhe trupave përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar në shtatë (7) rajonet zhvillimore, në përputhje me Neni 14 të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Neni 6
Fushëveprimtaria e Qendrave për zhvillim rajonal

1. Fushëveprimtaria e Qendrave për zhvillim rajonal në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji është përcaktuar si vijon:

1.1. Mbështetje në procesin e hartimit të politikave dhe programeve për zhvillim rajonal të balancuar si dhe planeve të tyre përkatëse të zbatimit Konform Ligjit përgjegjës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

1.2. Koordinimi i procesit të hartimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të rajoneve përkatëse zhvillimore dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale, në përputhjeme Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

1.3. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve tjera që veprojnë në rajonet përkatëse zhvillimore në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim realizimin e Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal në rajonet zhvillimore.

1.4. Mbështetja e organizatave të sektorit privat në rajonet përkatëse zhvillimore, në avancimin e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve investuese, me qëllim të shfrytëzimit më efikas të mundësive për mbështetje financiare nga programet qeveritare dhe donatorëve, me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillim ekonomik.

1.5. Grumbullimi i të dhënave statistikore dhe informatave tjera relevante nga institucionet përgjegjëse për rajonet përkatëse zhvillimore të cilat janë të nevojshme për matjen e ndryshimeve tek indikatorët socio-ekonomik të ndërlidhur me zhvillimin rajonal të balancuar të cilat shfrytëzohen për proceset e raportimit dhe të planifikimit.

KAPITULLI III
KRITERET E FINANCIMIT, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Neni 7
Planifikimi i mbështetjes financiare

1 Financimi i shpenzimeve operative të Qendrave për Zhvillim Rajonal në lidhshmëri me zbatimin e fushëveprimit nga Neni 6 i kësaj rregulloreje, bëhet në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit në mes institucioneve dhe trupave përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar në shtatë (7) rajonet zhvillimore, në përputhje me Neni 14 të ligjit, si dhe me pikën 1.10 të Nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

REPUBLIKA E KOSOVO KOMUNA E PEJË KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ OPŠTINA PEĆ REPUBLIKA KOSOVO

KRYESUES I KPF-së,
z. Rexhep Kurtbogaj

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, datë: 04. Qershor 2008, nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 13 Nëntor 2026, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

K O N K L U Z I O N

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton dhe miraton propozimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

Kuvendi Komunal
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
EMRI I INSTITUCIONIT / KOMUNA E PEJËS / OPŠTINA PEĆ / OPĆINA PEĆ
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
HYRËSE - DALËSE
Nr./Br./No. 01/610 Nr. i faq / Broj str. / No. pg 85240
Data/Datum/Date 13/11/2026

I. Numër:
Pejë, date: 13 Nëntor 2026

KUVENDI I KOMUNËS PEJË
Komiteti për Politikë e Financa -KPF

REPUBLIKA E KOSOVA
KOMUNA E PEJËS
KUVENDI I KOMUNËS
SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ
OPŠTINA PEĆ
REPUBLIKA KOSOVO

KRYESUES I KPF-së,
z. Rexhep Kurtbogaj

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, datë: 04. Qershor 2008, nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 13 Nëntor 2026, në propozim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

K O N K L U Z I O N

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton informatën mbi draft Planin paraprak Vjetor të Prokurimit Publik për vitin 2027 në Komunën e Pejës, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

Kuvendi Komunal
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
EMRI I INSTITUCIONIT / KOMUNA E PEJËS / OPŠTINA PEĆ / OPĆINA PEĆ
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
HYRËSE - DALEĆE
Nr./Br./No. 01-016/01-85238
Data/Datum/Date 13/11/2026

I. Numër:
Pejë, date: 13 Nëntor 2026

KUVENDI I KOMUNËS PEJË
Komiteti për Politikë e Financa -KPF

KRYESUES I KPF-së,
z. Rexhep Kurtbogaj

REPUBLIKA E KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS PEJË
SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ
OPŠTINA PEĆ
REPUBLIKA KOSOVO

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të datës 20 shkurt 2008, si dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020, me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020, të datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, më datë 04.11.2026, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe t'i rekomandojë Kuvendit të Komunës miratimin e normës tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës për vitin 2027.

Për zbatimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF);
- Arkivit.

KOMUNA E PEJËS

I.nr. 016/04-83054 **/ 2026**
Pejë, 04 Nëntor 2026

Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E PEJËS ZYRA E KRYETARIT OPŠTINA PEČ REPUBLIKA KOSOVO

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKSB

Draft-Plani i Punës për vitin 2027

Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Hyrje

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Plani Vjetor i Punës së KKSB-së, përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky draft-plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrativ për KKSB-në.

Roli i KKSB-së në komunën tonë është i rëndësishëm sepse grumbullon shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.
KKSB në Pejë drejtohet nga kryetari i komunës së Pejës z.Gazmend Muhaxheri në bashkëpunim të ngushtë me komandantin e policisë së Pejës dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm me përfaqësues të bashkësive etnike si ajo serbe, boshnjake, rome dhe egjiptiane, përfaqësuesit e bashkësive fetare si ajo myslimane, katolike, ortodokse dhe protestante, përfaqësues të organizatave jo qeveritare, të biznesit dhe ekipe për siguri publike në bashkësi, nën monitorim të autoriteteve nacionale siç është Departamenti i Sigurisë Publike dhe autoriteti i inspektoratit të policisë si dhe të organizatave ndërkombëtare si OSBE, KFOR dhe UN.
Nëpërmjet KKSB-së arrihet të kuptohen shqetësimet e të gjithë qytetarëve në komunën e Pejës dhe të ndërmerren hapa konkret për zgjidhjen e atyre problemeve. Duke qenë të bindur në rolin e rëndësishëm që ka KKSB, komuna e Pejës është në maksimum e përkushtuar që plani i punës së KKSB-së të zbatohet me përpikëri.
Çdo komunë është e obliguar të themelojë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. KKSB themelohet me vendim të kuvendit të komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës. Mandati i KKSB-së është 4 vite dhe korrespondon me periudhën e mandatit të Kuvendit të Komunës. Në mënyrë që me sukses të kryej misionin e vetë, duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, KKSB duhet të përpilojë dhe ta miratojë planin e punës për vitin vijues. Pas miratimit të planit të punës nga vetë KKSB, plani prezantohet dhe shqyrtohet edhe në kuvendin e komunës përkatëse.

Qëllimi i planit të punës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara me këtë plan, por do të jetë aktiv edhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme dhe trajtimin e kërkesave të tyre të kësaj natyre

Plani i punës i KKSB-së ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së qytetarëve duke u kujdesur për problematika të cilat e prekin drejtpërdrejtë jetën e tyre. Plani i punës ofron qartësi në veprim, definon problematikat dhe afatet që do të trajtohen gjatë vitit, paraqet rezultatet e pritura, tregon se kush janë autoritetet përgjegjëse për të marrë masa në zgjidhjen e problemeve.

Objektivat

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL KKSB duhet të mbaj së paku 6 mbledhje gjatë vitit. Në këto mbledhje shqyrtohen probleme të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve. Duke u bazuar në këto udhëzime, KKSB në Pejë për vitin 2027, përveç mbajtjes së 6 mbledhjeve të obligueshme, synon që të shqyrtojë këto çështje të sigurisë:

1. Rritja e vedijësimit të qytetarëve lidhur me natyrën e sigurisë;
2. Monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Pejës
3. Identifikimi i dukurive negative dhe shqetësimeve lidhur me sigurinë publike;
4. Parandalimi i veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi;
5. Ndërtimi i besimit dhe bashkëpunimit në mes të komunës së Pejës, Policisë së Kosovës, forumeve tjera të sigurisë dhe qytetarëve më qëllim të rritjes së sigurisë në bashkësi;
6. Rritja e sigurisë në shkolla në të gjitha nivelet;
7. Mbajtja e evidencave për problemet e shqyrtuara dhe për progresin e arritur në zgjidhjen e problemit;

Rezultatet e pritura

Duke vepruar siç është cekur më sipër dhe duke u përqendruar në objektivat e shënuara mësipër situata do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Për qytetarët do të sigurohet më shumë siguri në të gjitha fushat.

➢ PLANI I PUNËS SË KKSB-së PËR VITIN 2027

Në formë tabelare paraqitet si:

Kategorizimi	Nr.	Temat për shqyrtim	Bartësit	Periudha e raportimit
Gjendja aktuale në Komunë	1	Paraqitja e gjendjes aktuale në Komunë.	Kryetari i Komunës,	Shkurt Prill Qershor Shtator Nëntor Dhjetor
	2	Raport dhe vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Pejës, rritja e bashkëpunimit me policinë.	Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë,	
Shëndetësia	3	Sëmundjet sezonale dhe masat parandaluese; Fushata për vedijësim shëndetësor Gjendja me barna dhe material esencial në QKMF, QMF, AMF;	Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Pejës,	Shkurt
Arsimi	4	Arsimi, gjendja në shkolla dhe situata e zhvillimit të procesit arsimor.	Të raportohet nga: Drejtoria e Arsimit, Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë, Drejtoria e Inspeksionit	Shkurt Prill Qershor Shtator Nëntor Dhjetor
	5	Siguria në shkolla, parandalimi i përdorimit të substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme. Angazhimet në parandalimin e sjelljeve devijuese dhe dhunës në shkollat e komunës së Pejës, me theks të veçant në shkollat e mesme.		
	6	Transporti në viset rurale (bartja e nxënësve).		
	7	Mbikëqyerja e vazhdueshme e lokaleve – kafiterive, veçanarisht ato që ekzistojnë afër objekteve shkollore, ku mundësitë për trafikim me substancë narkotike janë më të mëdha.		
	8	Pajisjet me kamera dhe sigurimi fizik i objekteve shkollore.	Administrata e Përgjithshme (sektori i kamerave)	
	9	Mirëmbajtja e shkollave siguria në dhe për rreth objekteve shkollore. Delikuenca e nxënësve, mbarëvajtja e procesit arsimor nga ana e mësimdhënësve.	Të raportohet nga DKA, Këshilli i prindërve, Psikologët e shkollave;	
	10	Gjendja e shkollave sipas rezultateve të testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta dhe Maturës Shtetërore	Të raportohet nga DKA;	Qershor
Ambienti	11	Mbrojtja e lumenjëve që rrjedhin në komunën e Pejës, mbrojtja e pyjeve dhe ruajtja e ambientit në përgjithësi.	Të ftohen në bashkëbisedim nga zyret përgjegjëse: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe	

	12	Eliminimi i deponimeve ilegale, mbeturinave si dhe pastrami i rrugëve Situate në komunë me ndriçim publik, Situata me qenë endacak në komunën e Pejës.	Hidroekonomi,Inspeksionit, Drejtoria e Sherbimeve Publike. Policia dhe këshillat lokale.	Qershor
	13	Prerja ilegale e pyjeve. Gjuetia e paligjshme. Peshkimi i paligjshëm.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, Agjencioni pyjor; OJQ për çështje mjedisore;	Qershor
Mjedisi Urban	14	Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve; Gjelbërimi.	Kompania Rajonale për Mirëmbajtjen e Kanaleve; Drejtoria për Bujqësi, Pylltari; Drejtoria e Emergjencës.	Qershor Nëntor
	15	Masat e nevojshme për rregullimin e shtretërve të lumenjëve, kanaleve kulluese, organizimi dhe mbikëqyerja e zhbllokimeve të rrjetit të kanalizimit përgjatë rrugëve dhe tokave bujqësore.		
	16	Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve dhe djegieve të pyjeve dhe vërshimeve.		
Siguria	17	Siguria në trafik. Sinjalizimi. Parkingjet - parkimi i paligjshëm i automjeteve, pengesë për lëvizjen e lirë të qytetarëve.	Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike. Raport nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (sektori i kamerave); Policia e Kosovës; Anëtarët e KKSB-së, përfaqësues të komuniteteve; KLSP-të.	Shtator Dhjetor
	18	Sanimi i rrugëve - probleme me infrastrukturën rrugore në disa pjesë (dëmtime, gropa në rrugët e qytetit dhe fshatrave) si dhe Siguria në Komunë me ndriçim publik (Kamerat e qytetit).		
	19	Informatë për promovimine e vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera.		
	20	Identifikimi i brengave dhe shqetësimeve të qytetarëve .		
	21	Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.	Të ftohen në bashkëbisedim nga Drejtoria e Inspeksionit dhe AVUK.	Shtator Dhjetor
	22	Inspektimi i lokaleve lidhur me respektimin e ndalesës për pirjen e duhanit.		
	23	Shitja/Blerja e ushqimit të përditshëm, prodhim i pakontrolluar, datat e skaduara të prodhimeve.		
	24	Marrja e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve		

		piroteknike gjatë festave të fundvitit.		
Të Drejtat e Njeriut	25	Riintegrimi i personave të riatdhesuar. Projektet për kthim dhe riintegrim të të kthyerve si dhe stabilizim të komuniteteve.	Të ftohet në bashkëbisedim Institucionet relevante, - Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim IOM dhe organizatat tjera që e trajtojnë këtë çështje.	Dhjetor
	26	Mbrojtja e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare si dhe mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në riintegrim të viktimës. Mbrojtja e personave të cilët privohen nga të drejtat themelore; Lëmosh-kërkuesit – parandalimi i lypsarëve me theks të veçant fëmijëve;	Të ftohen në bashkëbisedim institucionet relevante, Drejtoria e Mirëqenies Sociale; si dhe OJQ-të që merren me çështje të dhunës në familje.	Dhjetor

Përmbledhje

Në këtë plan të punës janë paraqitur informacione për KKSB-në, aktet që e rregullojnë veprimtarinë e saj. Po ashtu është paraqitur qëllimi i planit të punës, objektivat e planit, aktivitetet që do të ndërmerren nga anëtarët e KKSB-së për t'i arritur objektivat si dhe janë paraqitur rezultatet e pritura dhe afatet kohore.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
I.Numër: , datë: Shtator 2027.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2.pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04. Qershor 2008"), nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit dhe Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date, … Shtator 2025, merr:

Draft -V E N D I M
Nr. ----/2027
mbi miratimin e Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027

1. **MIRATOHET** kalendari i takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027 në tekst siç është propozuar.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë kalendaret e takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

3. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e Komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e kuvendit dhe do të publikohet në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

Vendimi ti dërgohet:
1. Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit
2. Kryesuesit dhe anëtareve të Kuvendit
3. Arkivë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Kalendari i Takimeve të Komitetit për Politik e Financa – Pejë për vitin 2027

Muaji	Takimi	Data e dërgimit të materialit	Dita/Data e Takimit
Janar	Takimi i KPF	E Martë 05. Janar 2027	E Premte, 15. Janar 2027
Shkurt	Takimi i KPF	E Enjte, 04. Shkurt 2027	E Premte, 12. Shkurt 2027
Mars	Takimi i KPF	E Premte, 05. Mars 2027	E Mërkure, 17. Mars 2027
Prill	Takimi i KPF	E Hënë, 05. Prill 2027	E Mërkure, 14. Prill 2027
Maj	Takimi i KPF	E Mërkure, 05. Maj 2027	E Hënë, 17. Maj 2027
Qershor	Takimi i KPF	E Premte, 04. Qershor 2027	E Enjte, 17. Qershor 2027
Korrik	Takimi i KPF	E Hënë, 05. Korrik 2027	E Enjte, 15. Korrik 2027
Gusht	*PUSHIM VJETOR*	*PUSHIM VJETOR*	*PUSHIM VJETOR*
Shtator	Takimi i KPF	E Premte, 03. Shtator 2027	E Mërkure, 15 Shtator 2027
Tetor	Takimi i KPF	E Martë, 05. Tetor 2027	E Premte, 15.Tetor 2027
Nëntor	Takimi i KPF	E Premte, 05. Nëntor 2027	E Mërkure, 17. Nëntor 2027
Dhjetor	Takimi i KPF	E Hënë 06. Dhjetor 2027	E Enjte, 16. Dhjetor 2027

Shënim: a) Të gjitha takimet e theksuara më lartë do të mbahen me fillim në orën 11:00.
b) Takimet e jashtëzakonshme mund të mbahen në kushtet të përcaktuara me nenin 44. paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
c) Takimet mbahen në afatin e caktuar, por për arsye objektive data e caktuar dhe ora, mund të lëvizin apo takimi të mbahet ndonjë ditë më vonë se që është caktuar me këtë kalendar.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

Kalendari i Takimeve të Kuvendit të Komunës së Pejës, për vitin 2027

Muaji	Takimi	Data e dërgimit të materialit	Dita/Data e Takimit
Janar	Takimi i K.K.	E Premte, 15. Janar 2027	E Mërkure 27. Janar 2027
Shkurt	Takimi i K.K.	E Premte, 12. Shkurt 2027	E Premte, 26.Shkurt 2027
Mars	Takimi i K.K.	E Mërkure, 17. Mars 2027	E Martë, 30. Mars 2027
Prill	Takimi i K.K.	E Mërkure, 14. Prill 2027	E Mërkure, 28. Prill 2027
Maj	Takimi i K.K.	E Hënë, 17. Maj 2027	E Premte, 28. Maj 2027
Qershor	Takimi i K.K.	E Enjte, 17. Qershor 2027	E Martë, 29. Qershor 2027
Qershor	*Takim publik me qytetar*	*Takimi i parë publik*	*E Enjte me dt. 24.06.2027*
Korrik	Takimi i K.K.	E Enjte, 15. Korrik 2027	E Mërkure, 28. Korrik 2027
Gusht	*PUSHIM VJETOR*	*PUSHIM VJETOR*	*PUSHIM VJETOR*
Shtator	Takimi i K.K.	E Mërkure, 15 Shtator 2027	E Martë, 28. Shtator 2027
Takim	Takimi i K.K.	E Premte, 15.Tetor 2027	E Enjte, 28. Tetor 2027
Nëntor	Takimi i K.K.	E Mërkure, 17. Nëntor 2027	E Hënë, 29. Nëntor 2027
Dhjetor	Takimi i K.K.	E Enjte, 16. Dhjetor 2027	E Martë, 28. Dhjetor 2024
Dhjetor	*Takim Publik me qytetar*	*Takim i dytë publik*	*E Hënë, dt. 20. Dhjetor 2027*

Shënim: a) Të gjitha takimet e theksuara më lartë do të mbahen me fillim në orën 10:00.
b) Takimet e jashtëzakonshme mund të mbahen në kushtet të përcaktuara me nenin 44. paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
c) Takimet mbahen në afatin e caktuar, por për arsye objektive datat e caktuara mund të lëvizin apo takimi të mbahet ndonjë ditë më vonë se që janë caktuar me këtë kalendar.

(Logo e Komunës)

Për: Anëtarët e Kuvendit Komunal të Pejës

Nga: Gazmend Muhaxheri, Kryetari i Komunës së Pejës

Lënda: Miratimi i marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërkomunal për Rajonin Zhvillimor Perëndim

Data: ...

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

Draft marrëveshja e bashkangjitur është iniciuar si nismën për bashkëpunim ndërkomunal nga Ministria për Zhvillim Rajonal, me mbështetjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, gjatë takimeve të përbashkët të Kryetarëve të Komunave të Rajonit Perëndimorë me udhëheqës të këtyre ministrive, të zhvilluara gjatë viteve 2025 dhe 2026 në Pejë, nën organizimin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal - Perëndim. Bazuar në këto takime ndër-institucionale, Ministrat përkatës të këtyre dy ministrive të lartcekura kanë dërguar shkresën e bashkangjitur të datës 26.06.2026 tek Kryetarët e Komunave, për inicimin e nismës në Kuvendet Komunale për miratimin e marrëveshjes së re për bashkëpunim ndërkomunal.

Kjo draft marrëveshje ka për qëllim zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, si dhe aktet përkatëse nënligjore, me qëllim të ndryshimit dhe zëvendësimit të marrëveshjes ndërkomunale ekzistuese nga viti 2008, të miratuar nga Kuvendet Komunale të Pejës, Gjakovës, Klinës, Istogut, Deçanit dhe Junikut, mbi bashkëpunimin ndërkomunal në Zonën Ekonomike Perëndimore të Kosovës për qëllime të zhvillimit rajonal. Baza ligjore mbi të cilën Ministria e Zhvillimit Rajonal ka hartuar këtë draft marrëveshje, në koordinim edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, është Ligji Nr. 04/L0-10 për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Arsyeja primare për ndryshimin e kërkuar ndërlidhet me ri-organizimin e rajoneve zhvillimore në Kosovë në bazë të ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar nga pesë rajone ekzistuese në shtatë rajone sipas klasifikimit NUTS-3 të përcaktuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës bazuar në nomenklaturën Evropiane të njësive territoriale brenda Kosovës. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi, rajoni perëndimor i Kosovës do të ketë vetëm katër Komuna (Peja, Istogu, Klina dhe Deçani), ndërsa Gjakova dhe Juniku do bëhen pjesë e rajonit zhvillimor jugperëndim, ku do bashkëngjiten Rahoveci dhe Malisheva.

Kjo marrëveshje gjithashtu ndërlidhet drejtpërdrejt edhe me zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar që kanë të bëjnë me hartimin e Planit Operacional në nivelin e rajonit, nga strukturat përkatëse të përbëra nga zyrtarë të Komunave të rajonit, nën koordinimin e Qendrës për Zhvillim Rajonal. Ky Plan Operacional do t'i parasheh në vazhdimësi prioritetet zhvillimore të rajonit dhe Komunave përkatëse për një periudhë tre vjeçare, të cilat pastaj do të adresohen nga Programi i Zhvillimit Rajonal i menaxhuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, si dhe nga dikaster të tjerë qeveritarë përmes MZHR-së, si dhe nga burime të tjera financiare nga komuniteti i donatorëve i cili vepron në Kosovë.

Me miratimin e draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërkomunal për Rajonin Zhvillimor Perëndim, Kuvendi Komunal do e autorizojë Kryetarin e Komunës që në emër të Komunës të nënshkruaj marrëveshjen së bashku me Kryetarët e tre Komunave të tjera të Rajonit Perëndim. Siç është cekur, kjo marrëveshje e re do zëvendësojë marrëveshjen e vitit 2008, dhe do të hap rrugë për ndryshimet në Statutin e AZHR-Perëndim dhe vendosjen e strukturave përkatëse planifikuese të cilat do të zhvillojnë Planin Operacional dhe projektet e ndërlidhura me këtë plan.

Me respekt,

Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

(DRAFT)
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËR-KOMUNALE PËR

RAJONIN ZHVILLIMOR PERËNDIM

E lidhur ndërmjet:

- Komunës së Pejës, përfaqësuar nga Gazmend Muhaxhiri, Kryetar i Komunës
- Komunës së Istogu, përfaqësuar nga Ilir Ferati, Kryetar i Komunës
- Komunës së Klinës, përfaqësuar nga Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës
- Komunës së Deçanit, përfaqësuar nga Bashkim Ramosaj, Kryetarë i Komunës

Baza Ligjore:

1. Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
2. Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar
3. Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër-komunal

Neni 1
Qëllimi i Marrëveshjes

1. Marrëveshja ka për qëllim themelimin, funksionimin, organizimin dhe monitorimin e Qendrës për Zhvillim Rajonal në rajonin zhvillimor Perëndim (në tekstin e mëposhtëm QZHR Perëndim).

2. Kryetarët e Komunave në rajonin zhvillimor Perëndim, zotohen për të bashkëpunuar në mënyrë që të përmirësojnë kualitetin e jetës së qytetarëve, të ofrojnë një ambient më të përshtatshëm socio – ekonomik dhe të rrisin ndikimin e masave për zhvillim rajonal të balancuar.

Neni 2
Rajoni zhvillimor Perëndim

1. Bazuar në Ligjin nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe aktet përkatëse nënligjore, rajoni zhvillimor Perëndim përfshinë territorin e komunave Pejë, Deçan, Istog dhe Klinë.

2. Komunat e rajonit zhvillimor Perëndim pajtohen të themelojnë QZHR Perëndim.

Neni 3
Qendra për Zhvillim Rajonal Perëndim

1. QZHR Perëndim mbulon komunat Pejë, Deçan, Istog dhe Klinë**.**

Neni 4
Fushëveprimtaria e Qendrës për Zhvillim Rajonal Perëndim

1. QZHR Perëndim për qëllime të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar do të jetë katalizator dhe bashkërendues për komunat e lartcekura**.**

2. Mbështetja në procesin e hartimit të politikave dhe strategjive zhvillimore të komunave të rajonit zhvillimor Perëndim, si dhe planeve përkatëse të zbatimit, me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

3. Bashkërendimi i procesit të hartimit të Planit Operacional për Zhvillim Rajonal të rajonit zhvillimor Perëndim në mes MZHR-së, Komunave të rajonit zhvillimor, dhe të gjithë hisedarëve rajonal, në përputhje me Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

4. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve tjera që veprojnë në rajonin zhvillimor Perëndim në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim realizimin e Planit Operacional për Zhvillim Rajonal në rajonin zhvillimor Perëndim.

5. Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile, si dhe sektorit privat në rajonin zhvillimor Perëndim, në avancimin e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve investuese, me qëllim të shfrytëzimit më efikas të mundësive për mbështetje financiare nga programet qeveritare dhe donatorëve, me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillim ekonomik.

6. Grumbullimi i të dhënave statistikore dhe informatave tjera relevante nga institucionet përkatëse për rajonin zhvillimor Perëndim, të cilat janë të nevojshme për matjen e ndryshimeve tek indikatorët socio-ekonomik të ndërlidhur me zhvillimin rajonal të balancuar, të cilat shfrytëzohen për proceset e raportimit dhe të planifikimit.

Neni 5
Qëllimi dhe synimet e QZHR Perëndim

1. Qëllimi i themelimit dhe funksionimit të QZHR Perëndim është promovimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar dhe të qëndrueshëm, përmes forcimit të partneriteteve dhe

bashkërendimit të aktiviteteve mes komunave të rajonit zhvillimor dhe gjithë hisedarëve përkatës. Ky bashkëpunim synon të krijojë mundësi për realizimin e projekteve të përbashkëta, duke siguruar një planifikim dhe zbatim të integruar që i përgjigjet nevojave dhe potencialeve të rajonit.

2. Përmes QZHR Perëndim, do të mundësohet optimizimi i shfrytëzimit të burimeve teknike dhe financiare për komunat, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve ekonomike, sociale dhe infrastrukturore në rajonin zhvillimor.

Neni 6
Organizimi dhe Struktura e Qendrës për Zhvillim Rajonal Perëndim

1. QZHR Perëndim do të funksionojë si një strukturë kyçe për koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të zhvillimit brenda rajonit zhvillimor.

2. QZHR Perëndim do të ketë strukturë drejtuese dhe ekzekutive për menaxhimin e aktiviteteve në përputhje me statutin e QZHR Perëndim.

   2.1. Kuvendi i Anëtarëve – Kuvendi i Anëtarëve përbëhet nga Kryetarët e Komunave të Rajonit Zhvillimor Perëndim.

   2.2. QZHR Perëndim do të ketë Drejtorin Ekzekutiv dhe së paku dy zyrtar të tjerë për të realizuar detyrat dhe funksionet e QZHR.

   2.3. QZHR Perëndim, me miratimin e Kuvendit të Anëtarëve, mund të angazhojë zyrtarë të tjerë përtej strukturës së paraparë me pikën 2.2., apo konsulentë të jashtëm pran QZHR Perëndim për periudha të caktuara kohore, me qëllim të realizimit të projekteve dhe përmbushjes së detyrave specifike në nivel të Komunave themeluese të QZHR-Perëndim apo në nivel të rajonit perëndim.

3. QZHR Perëndim ka selinë në Pejë.

4. Komuna e Pejës e cila është nikoqire e QZHR Perëndim ofron hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punë.

Neni 7
Detyrat dhe angazhimet e palëve

1. Komunat nënshkruese të kësaj marrëveshje angazhohen për të kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve duke ofruar mbështetje teknike, logjistike dhe financiare duke bashkëpunuar në nivel qendror dhe lokal për të adresuar nevojat specifike të rajonit.

2. QZHR Perëndim do të menaxhojë dhe koordinojë aktivitetet dhe projektet zhvillimore brenda rajonit, duke siguruar mbështetje për implementimin e politikave të zhvillimit rajonal dhe ofrimin e shërbimeve teknike dhe këshilluese për komunat. Ajo gjithashtu do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve të komunave dhe institucioneve lokale për menaxhimin e projekteve zhvillimore.

Neni 8
Burimet financiare

1. Financimi i QZHR Perëndim do të sigurohet nga disa burime të përcaktuara, si:

1.1. Procesi i zhvillimit dhe zbatimit të Planit Operacional mbështetet financiarisht nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) bazuar në Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Kontributi financiar i MZHR do të përcaktohet në bazë të vendimeve përkatëse vjetore.

1.2. Komunat zotohen për të siguruar mbështetje financiare nga buxheti komunal për QZHR Perëndim në emër të anëtarësisë vjetore.

1.2.1. Komuna nikoqire kontribuon me shumën vjetore prej jo më pak se 15,000.00 euro.

1.2.2. Kontributi i komunave të tjera bazohet në numrin e banorëve si më poshtë:

- 0 - 5,000 banor; jo më pak se 1,000.00 euro
- 5,001 - 10,000 banor; jo më pak se 2,000.00 euro
- 10,001 - 20,000 banor; jo më pak se 3,500.00 euro
- 20,001 - 30,000 banor; jo më pak se 4,500.00 euro
- 30,001 - 50,000 banor; jo më pak se 5,500.00 euro
- 50,001 - 70,000 banor; jo më pak se 6,500.00 euro
- 70,001 - 100,000 banor; jo më pak se 8,500.00 euro

1.3. MZHR, ministritë e linjës, Komunat dhe donatorët mund të kontribuojnë me mjete shtesë për aktivitetet të cilat janë në përputhje me Planin Operacional dhe dokumentet tjera planifikuese të rajonit zhvillimor Perëndim.

1.4. MZhR, ministritë e linjës, QZHR Perëndim dhe Komunat mund të bashkërendojnë me donatorë për të mbështetur projektet me karakter të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar dhe të qëndrueshëm rajonal.

1.5. QZHR Perëndim do të veprojë si menaxhuese e fondeve për projektet zhvillimore, duke kërkuar burime financiare nga grantet dhe programet e ndihmës ndërkombëtare si dhe mundësitë për të tërhequr investime private.

1.6. MZhR, QZHR Perëndim dhe Komunat do të bashkëpunojnë për të siguruar që fondet të përdoren në mënyrë efikase dhe transparente, duke monitoruar çdo fazë të realizimit të projekteve dhe duke ndarë burimet sipas prioriteteve të zhvillimit rajonal.

Neni 9
Monitorimi dhe Raportimi

1. Njësia përgjegjëse për Zhvillim Rajonal, monitoron në baza periodike zbatimin e Planeve Operacionale të aprovuara nga Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal.

2. Qendra për Zhvillim Rajonal Perëndim obligohet që më së largu deri me 31 Mars të vitit pasues të raportojë në Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe te Bordi Drejtues për implementimin e planit operacional të vitit paraprak.

3. Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe Komunat e Rajonit Zhvillimor Perëndim mund të kërkojnë raportime tjera në baza periodike.

4. Monitorimi i punës së QZHR-Perëndim nga ana e strukturës drejtuese, dhe raportimi i QZHR Perëndim pran strukturës drejtuese, do të bëhet në përputhje me Statutin e QZHR Perëndim.

5. Raportimi pran institucioneve të tjera nga ana e QZHR Perëndim do të bëhet në përputhje me kontratat apo marrëveshjet përkatëse të financimit.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Çdo mosmarrëveshje mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 11
Dispozitat kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje Agjencia për Zhvillim Rajonal Perëndim ndryshon emrin në Qendra për Zhvillim Rajonal Perëndim**.**

2. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, palët bien dakord që marrëveshja paraprake e bashkëpunimit ndër-komunal në Zonën Ekonomike Perëndim e lidhur në vitin 2008, anulohet dhe bëhet e pavlefshme nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Çdo angazhim, detyrim ose rregullim që ka qenë i përcaktuar në marrëveshjet e mëparshme, nuk do të ketë më fuqi ligjore dhe do të konsiderohet si i pavlefshëm nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje**.**

3. Stafi aktual i AZHR Perëndim kalon në QZHR Perëndim duke përfshirë edhe të gjitha Kontratat dhe asetetet ekzistuese.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit ndër-komunal bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga Ministria e përgjegjëse për qeverisje lokale.

Palët nënshkruese të marrëveshjes

Komuna	**Emri i Kryetarit**	**Nënshkrimi**
Komuna e Pejës	Gazmend Muhaxhiri	_____
Komuna e Istog	Ilir Ferati	_____
Komuna e Klinë	Zenun Elezaj	_____
Komuna e Deçanit	Bashkim Ramosaj	_____

Nënshkrimi me dt. _____ **2026** Vendi: **Pejë**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, të datës 20 shkurt 2008, dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020, me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020, të datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, më datë 12.11.2026, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I. I propozohet Kuvendit të Komunës së Pejës që ta shqyrtojë dhe miratojë Draft-Planin e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2027.

Për implementimin e këtij konkluzioni do të kujdeset Shërbimi i Zyrës së Kryetarit të Komunës së Pejës.

Konkluzioni i dërgohet:

- Kuvendit Komunal në Pejë;
- Zyrës së Kryetarit;
- Arkivës.

KOMUNA E PEJËS

I.nr. 01-016/01-84687 **/ 2026**
Pejë, 12 Nëntor 2026

Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E PEJES
ZYRA E KRYETARIT
OPŠTINA PEČ
REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, datë 20 shkurt 2008, dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020, me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020, datë 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, më datën 12.11.2026, pas shqyrtimit të kërkesës nr 01-016/01-84848/2026 të Drejtorisë për Administratë, nxjerr këtë:

K o n k l u z i o n

I propozohet Kuvendit të Komunës së Pejës që të shqyrtojë Vendimin nr. 92/2026 për kompensimin e anëtarëve të këshillave lokalë, në vlerë prej 100 euro për takim, për gjithsej gjashtë (6) takime brenda vitit 2026, në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoria për Administratë.

Konkluzioni dërgohet:
- Drejtorisë për Administratë;
- Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Pejë;
- Arkivit.

KOMUNA E PEJËS

I.nr.01-016/01-85098**2026**
Pejë 12 Nëntor 2026

Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E PEJËS ZYRA E KRYETARIT PRIJA GRADUCNAC OPSTINA PEČ REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, datë 20 shkurt 2008, dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020, me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020, datë 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, më datën 12.11.2026, pas shqyrtimit të kërkesës nr 01-016/01-84870/2026 të Drejtorisë për Administratë, nxjerr këtë:

K o n k l u z i o n

I propozohet Kuvendit të Komunës së Pejës që të shqyrtojë Vendimin nr. 91/2026, lidhur me kompensimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në vlerë prej 100 euro për takim, për gjithsej gjashtë (6) takime brenda vitit 2026, në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoria për Administratë.

Konkluzioni dërgohet:
- Drejtorisë për Administratë;
- Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Pejë;
- Arkivit.

KOMUNA E PEJËS

I.nr 01-016/01-85101 **2026**
Pejë 12 Nëntor 2026

Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E PEJËS ZYRA E KRYETARIT KRYETARI I KOMUNËS GAZMEND MUHAXHERI OPŠTINA PEČ REPUBLIKA KOSOVO